

VENDIM
“Ne Emer te Republikes”

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane e perbere prej:

GJYQTAR: Petrit ÇOMO

Asistuar nga sekretarja gjyqesore Entela SHEHU, me pjesemarrjen e prokurorit Julian ZONJA, sot, ne daten 18.10.2011, ne Tirane, mori ne shqyrtim ne seance gjyqesore publike kerkesen penale Nr.1114 Akti, qe i perket:

KERKUES: P.G, i biri i (.....), i dtl. (.....), lindur dhe banues ne (.....), Itali, perfaqesuar ne gjykim nga av.Ferdinand Doja, me licence nr. 134, me prokure te posaçme, nr. 5907 rep., dt. 03.05.2010, te noterit Dr. Alfredo De Martino (e perkthyer, si dhe e noterizuar nga gjuha italiane ne shqipe).

OBJEKTI: Kundershtim i vendimit te sekuestrimit dt. 16.04.2010, te Prokurorise prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane dhe kthimin e sendeve te sekuestruara me kete vendim.

BAZA LIGJORE: Neni 212 i KPPenale.

Gjykata pasi mori provat shkresore, degjoi avokatin e kerkuesit, i cili ne diskutimin perfundimtar kerkoi pranimin e kerkeses sipas objektit, prokurorin Julian Zonja, i cili kerkoi rrezimin e kerkeses, si e shqyrtoi çeshtjen ne teresi:

VEREN

Se kerkuesi P.G i eshte drejtuar gjykates me kete kerkese me objekt te siperpermendur.

Nga shqyrtimi gjyqesor rezultoi se ne dt. 16.04.2010, ne Prokurorine e Rrethit Gjyqesor Tirane, ne baze te kallzimit nr. 2365, referuar nga DPP Shtetit me shkresen nr. 509/13, dt. 16.04.2010, eshte regjistruar procedimi penal nr. 1530, per vepren penale te parashikuar nga neni 287 i KPenal. Sipas informacionit derguar organit te prokurorise nga Drejtoria Kunder Krimit Financiar, rezulton se DPPParave ka informuar se shtetasi italian A.L ne dt. 04-05.03.2010 ka kryer dy transferta drejt Shqiperise nga Sllovenia, gjithsej 500000 euro. Sipas deklarimit te ketij personi ne banke rezulton se kjo shume parash vinte nga shitja e nje zinxhiri dyqanesh ushqimore ne Gjermani. Perfituesi i ketyre transfertave ne Banken Veneto ne Shqiperi ishte shoqeria F. LLI Cassavechia Spa, me perfaqesues ligjor shtetasin italian R.C, me pronare vellezerit C. Kapitali i nenshkruar nga shoqeria meme ne Itali eshte 500000 euro. Dega e kesaj shoqerie ne Shqiperi eshte regjistruar prane QKR dt. 01.06.2009, me NIPT K 91801019 O, me adrese: Rr. “Abdyl Frasherit”, P. 32/1, Tirane. Ne

dt. 12.03.2010 shoqeria F. LLI Cassavechia Spa ka transferuar brenda bankes 490000 euro ne drejtim te shoqerise Agar Srl, me perfaqesues shtetasin italian P.G. Shoqeria Agar Srl eshte shoqeri italiane me qender ne Rome, e cila ushtron aktivitetin e saj si shoqeri e huaj e pa regjistruar ne QKR. Nga data 19.03.2010 deri ne dt. 29.03.2010, nga numri i llogarise Agar Srl jane bere tre terheqje cash ne shumen 60000 euro, nga P.G. Ne dt. 09.04.2010, DPPP Parave ka njoftuar se shtetasi P.G shumen e mbetur prej 427000 euro ka dashur ta transferoje ne nje nga llogarite e shoqerise se tij, apo ne llogarite e nje shoqerie tjeter italiane IF Srl. Ne dt. 14.04.2010 DPPPParave ka njoftuar Drejtorine Kunder Krimin Financiar se ka bere bllokim ne baze te ligjit te kesaj shume, duke kerkuar bashkepunim per hetimin e kesaj ceshtjeje. Policia shqiptare i ka kerkuar zyres nderlidhese te policise italiane ne Shqiperi Interforce, verifikimin e shtetasve P.G, A.L, si dhe te shoqerive F. LLI Casavecchia Spa dhe Agar Srl. Interforce ne pergjigjen e dt. 15.04.2010 ka konfirmuar denoncime dhe denime per shtetasin A.L, si dhe marrjen nen hetim nga autoritetet e drejtesise italiane per shtetasin P.G. Siç eshte permendur edhe me lart DPPPParave ne dt. 12.04.2010, ne zbatim te ligjit nr. 9917, dt. 19.05.2008, ka bere bllokimin e transaksionit bankar te shtetasit P.G, i cili ka dashur te transferoje shumen e mbetur ne llogarine e tij ne Banken Veneto ne Shqiperi 427000 euro, ne llogarine e tij ne banken Intesa SanPaolo, Shqiperi.

Duke u nisur nga origjina e dyshimte e kesaj shume te ardhur nepermjet ketyre transfertave te dyshimta, si dhe duke u bazuar ne backgroundin kriminal te personave te perfshire ne kete transaksion bankar, si derguesi ashtu dhe perfituesi, si dhe duke qene se afati ligjor i bllokimit te kesaj transferte nga DPPPParave ka perfunduar, oficeri i policise gjyqesore qe ka hartuar informacionin per prokurorine kerkon nga ky organ regjistrimin e procedimit penal per vepren penale te parashikuar nga neni 287/a i KPenal, vendosjen e sekuestros mbi llogarine e shtetasit italian P.G ne Banken Veneto.

Siç eshte permendur edhe me lart, pas marrjes se ketij informacioni ne Prokurorine e Rrethit Gjyqesor Tirane eshte regjistruar procedimi penal nr. 1530, dt. 16.04.2010. Gjithashtu me vendimin e dt. 16.04.2010 te prokurorit Julian Zonja eshte vendosur sekuestrimi i llogarise bankare te shoqerise Agar Srl, me perfaqesues shtetasin P.G ne shumen prej 427000 euro prane Bankes Veneto, Shqiperi. Ky vendim me shkresen nr. 1530 prot. JZ, dt. 16.04.2010, i eshte derguar Bankes Veneto, Tirane. Po ne kete date, 16.04.2010, oficeri i policise gjyqesore ka mbajtur procesverbalin per sekuestrimin e shumes se permendur me lart. Organi i prokurorise i ka kerkuar te dhena QKR Tirane per personat dhe subjektet qe kane lidhje me transaksionet financiare te permendura me lart dhe QKR i ka kthyer pergjigjet perkatese. Gjithashtu organi i prokurorise ka marre informacion per llogarite e personave dhe subjekteve ne Banken Veneto Tirane. Jane marre informacione per marreveshjet ndermjet shoqerive Agar Srl dhe shoqerise te vellezerve C. per kontrata per investime ne pasurite e paluajtshme, per zgjidhje kontratash e marreveshjesh. P.G me ane te avokatit Ferdinand Doja ka dorezuar ne prokurori certifikaten penale te tij, sipas te ciles ai rezulton i padenuar. Prokurori ka pyetur shtetasin P.G ne lidhje me transaksionet.

Duke qene se ka kaluar nje periudhe relativisht e gjate, me shume se nje vit nga data e regjistrimit te procedimit penal dhe vendosjes se sekuestros mbi llogarite bankare dhe organi i prokurorise nuk e ka marre te pandehur, nuk ka kryer veprime qe tregojne ndonje veprim kriminal te tij, kerkuesi i eshte drejtuar gjykates ne baze te nenit 212 te KPPenale, duke kerkuar heqjen e sekuestros.

Sipas kerkuesit organi i prokurorise ka arritur ne konkluzionin se ka te dhena ne lidhje me elementet e vepres penale te pastrimit te parave, pasi ekziston dyshimi mbi origjinen e

shumes 500000 euro, te transferuara fillimisht nga A.L nga Sllovenia ne Shqiperi, eshte quajtur veprimtari kriminale, veprimtaria e shtetasve A.L e P.G, si dhe duke justifikuar vendim-marrjen sipas nenit 210 te KPPenale, me legjitimimin e kushtit te urgjences, per faktin se P.G po ndermerrte veprime per transferimin e kesaj shume ne llogari te shoqerive te tjera. Sipas avokatit vendimi i prokurorise qe ne momentin e marrjes se tij nuk ka qene i mbeshtetur ne ligje e ne prova. Nuk gjejne mbeshtetje elementet e vepres penale te parashikuar nga neni 287 te KPenal. Per me teper mbas kalimit me shume se nje viti organi i prokurorise ende vazhdon te jete ne fazen e dyshimeve. Qe neni 287 i KPenal te konsiderohet i konsumuar kerkohet patjeter ekzistenca e nje vepre penale qe ka si pasoje nje produkt me nje vlere materiale apo monetare dhe ekzistenca e nje mekanizmi nepermjet veprimeve te cilat jane parashikuar ne kete dispozite, te cilat synojne qe kete produkt te vepres penale ta kthejne ne nje produkt te ligjshem. Organi i prokurorise nuk ka patur dhe nuk ka siguruar te dhena te cilat te tregojne qofte dhe dyshimin me te vogel ne lidhje me origjinen kriminale te parave te transferuara nga shtetasi A.L. Nuk ka te dhena edhe ne lidhje me verifikimin e deklarimeve te ketij shtetasi italian per burimin e ketyre parave. Organi i prokurorise perdor vetem faktin se A.L ka qene i hetuar ne shtetin italian per vepra penale ne fushen ekonomike. Organi i prokurorise i ka siguruar keto te dhena vetem nga autoritetet policore dhe jo nga ato gjyqesore, nuk ka arritur te provoje nese ekziston lidhja midis ketyre veprave penale dhe shumes se parave te transferuara prej tij. Avokati nenvizon faktin se deri ne keto momente A.L nuk eshte person nen hetim apo i pandehur ne kete ceshtje. Organi i prokurorise nuk ka patur dhe nuk ka siguruar te dhena, te cilat te tregojne qofte dhe dyshimin me te vogel ne lidhje me ekzistencen e nje mekanizmi qe ka per synim pastrimin e produktit te vepres penale, shumes prej 500000 euro, nga ana e perfaqesuesve te shoqerise F. LLI Cassavechia Spa, me perfaqesues ligjor shtetasin R. C. dhe shtetasit P.G, perfaqesues i shoqerise Agar Srl. E vetmja e dhene qe vazhdon te perdore prokuroria eshte qe ne kete mekanizem te transferimit te parave ka dyshime ne lidhje me llogjiken joekonomike dhe kohen e shkurter te kryerjes se ketyre trasnfertave. Por prokuroria nuk sjell asnje lloj prove dhe nuk argumenton asgje. Gjithashtu prokuroria argumenton ne lidhje me te ashtuquajturen veprimtari kriminale te shtetasit P.G, por ashtu si ne rastin e shtetasit A.L prokuroria nuk ka te dhena apo prova per ekzistencen e lidhjes se veprave penale per te cilat ky shtetas eshte hetuar ne Itali, me ekzistencen e kesaj shume, si dhe te lidhjeve te mundshme kriminale ndermjet ketyre dy shtetasve. Kjo ka bere qe edhe shtetasin P.G prokuroria nuk ka vendosur ta marre person nen hetim, apo te pandehur.

Prokuroria ka arsyetuar ne kundersizim me ligjin dhe me te dhenat persa i perket urgjences se vendim marrjes. E vetmja e dhene qe perdor prokuroria eshte veprimi i shtetasit italian P.G per transferimin, sipas prokurorise, te shumes 427 000 euro nga llogaria bankare e shoqerise Agar Srl, ne drejtim te llogarive bankare te shoqerive te tjera te ndodhura ne Itali. Prokuroria nuk ka asnje prove lidhur me kete moment i cili konsiderohet si shkaku kryesor per menyren e vendim-marrjes (urgjence), si dhe nje nga momentet e mekanizmit te pastrimit te produktit te vepres penale. Ne fakt ne daten kur eshte vendosur sekuestrimi i llogarise bankare veprimi i vetem i kryer nga P.G ka qene zevendesimi i Bankes Veneto Tirane, me banken Intesa SanPaolo Tirane, pra banka qe veprojne ne Shqiperi. Pikerisht kerkesa per transferimin e shumes nga Banka Veneto ne Banken Intesa SanPaolo, dega Tirane, ka qene shkaku qe autoritet e Bankes Veneto denoncuan kete rast si te dyshuar. Do te ishte ne nderin e asaj banke qe denoncimin e rastit ta kishte bere qe ditet e pare qe pranoi kete shume nga banka sllovene, dhe jo ne momentin kur u kerkuar transferimi i shumes ne nje banke tjeter.

Avokati kerkoi qe te merreshin si prova fotokopjet e materialeve qe ndodhen ne fashikullin e procedimit penal nr. 1530, viti 2010. Prokurori i paraqiti nje pjese te ketyre materialeve, te cilat sipas tij ishin te nevojshme per zbardhjen e ceshtjes. Sipas avokatit vendimi i prokurorise eshte ne kundershtrim me nenin 210 te KPPenale dhe nenin 287 te KPenal, prandaj ai i eshte drejtuar gjykates ne baze te nenit 212 te KPPenale.

Si perfundim avokati i kerkuesit kerkoi prishjen e vendimit te sekuestrimit date 16.04.2010 te Prokurorise prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane dhe heqjen e sekuestrimit mbi llogarine bankare te shoqerise Agar Srl, me perfaqesues shtetasin P.G, ne shumen prej 427000 euro, prane Bankes Veneto Shqiperi.

Prokurori i kundershtoi pretendimet e kerkuesit. Sipas tij procedimi penal ka filluar pas informacionit te DPPPParave, e cila ka bere bllokimin ne baze te ligjit te shumes se transferuar nga A.L nga Sllovenia. Per kete shume me pas eshte vendosur sekuestrimi i saj prane Bankes Veneto, ne kuader te procedimit penal te regjistruar per vepren penale te parashikuar nga neni 287 i KPenal. Sipas prokurorit kerkesa eshte e pabazuar ne ligj. Se pari, vendimi i sekuestrimit eshte marre ne baze te neneve 208 e 210 te KPPenale, per shkak te dyshimeve se shuma e mesiperme eshte e ardhur apo produkt i nje veprimtarie kriminale. Dyshime te tilla kane lindur nga fakti se shtetasi A.L ne dt. 04-05.03.2010 ka kryer dy transfertat drejt Shqiperise nga Sllovenia ne shumen 500000 euro. Sipas deklarimeve te tij te bera ne Banken Sllovene ne momentin e transfertave kjo shume parash vinte nga shitja e nje zinxhiri dyqanesh ushqimore ne Gjermani. Perfitues i ketyre transfertave ne Banken Veneto ne Shqiperi ishte shoqeria F.LLI C. Spa, prone e vellezerve C., shtetas italiane. Dega e kesaj shoqerie ne Shqiperi eshte regjistruar prane QKR, ne dt. 01.06.2009. ne dt. 12.03.2010, shoqeria F.LLI C. Spa ka transferuar brenda bankes 490000 euro ne drejtim te shoqerise Agar Srl me pershkrim kthim fondi per moskryerje investimi. Shoqeria Agar Srl eshte shoqeri italiane me qender ne Rome, e cila nuk eshte e regjistruar ne Shqiperi. Me pas nga numri i shoqerise Agar Srl jane bere tre terheqje cash nga P.G, ne dt. 19.03.2010 shuma 10000 euro, ne dt. 23.03.2010, shuma 30000 euro ne dt. 29.03.2010 shuma 20000 euro. P.G shumen prej 427000 euro te mbetura ne llogari ka kerkuar ta transferonte ne Itali, ne nje nga llogarite e shoqerise se tij atje, apo ne llogarine e nje shoqerie tjeter italiane atje, IF Srl. Duke qene se arsyetimi i klientit se keto fonde do te transferoheshin me qellim hapjen e nje filiali te shoqerise ne Shqiperi u pa nga banka si i pabaze, si dhe duke munguar dokumentacioni justifikues per transferimin e ketij fondi, bazuar ne rregulloren e Bankes se Shqiperise, Banka Veneto nuk e kreu transfertin. Pas refuzimit te transfertes P.G eshte regjistruar si person fizik ne QKR ne dt. 07.04.2010, me veprimtari tregtim me pakice veshje. Si i tille ai ka hapur nje llogari ne banken Intesa SanPaolo dhe ka kerkuar serish nga Banka Veneto te transferonte fondet ne llogarine e re. Nisur nga dyshimet qe banka kishte mbi arsyet e kryerjes se transakcionit nuke ka kryer ate dhe e ka raportuar prane DPPPParave si nje rast te dyshimte. P.G eshte perpjekur me ane te telefonit te kryeje transfertin e shumes 427 000 euro nga llogaria e tij ne Banken Veneto ne llogarine e tij ne Banken Intesa SanPaolo. Banka ka refuzuar te kryeje transakcione dhe i ka kerkuar te sjelle dokumentacionin e duhur. Ne dt. 13.04.2010 P.G ka derguar me faks disa dokumente ne banken Veneto per te vertetuar burimin e fondeve qe kerkonte te transferonte. Ai ka pretenduar se keto dokumente jane derguar me faks nga Italia, por ne dokumente eshte bere i padukshem numri i faksit nga i cili jane derguar. Gjithashtu sipas prokurorit personat e perfshire ne transakcione, A.L, P.G, G e R. C., njihen si persona me precedente penale dhe aktivitet kriminal. Shuma e sekuestruar eshte transferuar nga A.L ne llogari te firmes Agar Srl, nderkohe qe nga aktet nuk rezulton qe

ky shtetas te kete lidhje me kete shoqeri. E vetmja e dhene sipas dokumentacionit te derguar nga P.G tek Banka Veneto, eshte marreveshja e dt. 01.03.2010, lidhur ne Fossombrone, Itali, ku P.G ka nenshkruar si i autorizuar nga A.L, por ne fakt nuk ka asnje akt qe ta tregojte ate. Kjo marreveshje eshte zgjidhur ne dt. 12.03.2010 me ane te nje deklarate te nenshkruar ne Tirane nga P.G e G C.. Nga verifikimi ne sistemin TIMS rezulton se G C. nuk ka qene ne Shqiperi ne dt. 12.03.2010. Gjithashtu dokumentacioni i depozituar nga F. LLI C. tek Banka Veneto per transferimin e shumes 490000 euro ne dt. 12.03.2010 eshte i ndryshem nga dokumentacioni i depozituar nga P.G per terheqjen e shumes. Akt - marreveshja ndermjet Agar Srl e F. LLI C. ketu eshte e dt.05.03.2010 dhe ndryshon ne permbajtje e shkrim. Nga nje dokument tjeter, kontrate sherbimi dt. 15.04.2010, midis Agar Srl e P.G rezulton se shoqeria do ti paguaje P.Gt nje shume parardhnie 426900 euro, per sherbimet qe ky do te kryeje, pra shuma del per nje qellim krejtesisht tjeter nga deklarimet e bera ne dokumentacionin e meparshem te depozituar ne Banken Veneto. Nderkohe qe nuk ka llogjike qe P.G te nenshkruaje nje kontrate me veten e tij, duke qene perfaqesues i Shoqerise Agar Srl. Vihet re se i gjithe dokumentacioni nuk eshte hartuar prane nje noteri, por jane deklarata midis paleve. Duke pare justifikimet e ndryshme te shumes se sekuestruar, faktin qe edhe llogaria bankare e shoqerise Agar Srl prane Bankes Veneto eshte hapur ne daten kur eshte transferuar shuma, dt. 12.03.2010 dhe dokumentacioni i zgjidhjes se marreveshjes midis paleve mban po kete date, ka arsye per te besuar se ky dokumentacion eshte fiktiv. Gjithnje sipas prokurorit faktet e provuara permendur me lart mbeshtesin dyshimin se shuma e sekuestruar mund te jete produkt i nje vepre penale, e cila eshte edhe objekt i te provuarit nga hetimet paraprake.

Se dyti, shtetasi P.G nuk legjitimohet te kundersiztojte vendimin e sekuestrimit ne gjykate, per shkak se nuk eshte as i pandehur dhe as personi i cili ka te drejten per kthimin e sendit te sekuestruar, kur kjo shume eshte transferuar nga A.L. P.G nuk mund te veproje as si perfaqesues i ketij te fundit, pasi nuk eshte i autorizuar prej tij. Aq me teper shoqeria Agar Srl, perfaqesues i se ciles eshte P.G, nuk mund te shfaqet si perfituese, ose e demtuar, pasi shuma i perket A.Lt, te cilit do t'i kthehej pas zgjidhjes se marreveshjes. Sipas prokurorit kerkesa eshte e pambeshtetur edhe proceduralisht, duke iu referuar fazes ne te cilen ndodhen hetimet e kesaj ceshtjeje penale, pasi pasuria e sekuestruar eshte objekt i vepres penale te pastrimit te produkteve te vepres penale. Aktualisht konfirmimi zyrtar per precedente penale ne lidhje me personat e perfshire ne transakcionet me shumen e sekuestruar ka ardhur nga zyra e Interpolit ne muajin gusht 2011 me shkresen 1619/3 prot., ndersa me shkresen nr. 808/39, dt. 08.04.2011, DPPParave ka informuar se eshte ne investigim te ketij rasti dhe vijon korespondencen me homologet sllovene per te marre te dhena te tjera. Prokuroria i eshte drejtuar me leter-porosi autoriteteve kompetente per marrjen e provave te nevojshme. Veprat penale te pastrimit te produkteve te vepres penale paraqesin veshtiresi ne hetimin e tyre, sidomos kur vepra penale kryesore nga e cila kane rrjedhur produktet eshte kryer jashte shtetit, si ne rastin konkret. Nese do te pranohet kerkesa do te humbiste objekti. Aq me teper vendimi gjyqesor do te vinte ne kundersiztim me faktet e permendura me lart, pra gjykates do t'i duhej te pranonte se per shumen e sekuestruar nuk ka dyshime se eshte produkt i nje vepre penale. Vendimi i gjykates do te ishte i pabazuar ne momentin kur po zhvillohen hetime, duke cenuar te drejten e prokurorit per te provuar vepren penale e cila ka lidhje me shumen e sekuestruar, gje e cila do te demtonte hetimin ne menyre te pariparueshme, sidomos pa provuar ende nese vertete kjo shume eshte siguruar nga shitja e dyqaneve ne Gjermani ne menyre te ligjshme nga A.L. Ne kete faze kjo eshte detyra me e rendesishme, pasi ekzistojne

dhe jane te mjaftueshme dyshimet se shuma e sekuestruar eshte produkt i veprave penale, per te vijuar me hetimin e vepres penale kryesore, duke patur parasysh se personat e perfshire njihen nga autoritetet per veprat penale qe prodhojne pasuri te tjera. Kjo detyre i takon organit te prokurorise i cili ne fund te hetimit do te percaktoje edhe disponimin ne lidhje me pasurine e sekuestruar, pavaresisht kohezgjatjes per shkak te arsyeve te permendura me lart. Ne rastin konkret kjo kohezgjatje vjen edhe per shkak te mbledhjes se provave nga autoriteteve te huaja kerkuar me leterporosi per vepren penale kryesore nga kane rrjedhur te ardhurat e dergimin e tyre ne Shqiperi.

Si perfundim prokurori kerkoi rrezimin e kerkeses, si te pambeshtetur ne nenin 212 te KPPenale.

Sa me siper u provuan gjate gjykimit me provat shkresore te administruara ne seance gjyqesore, si dhe me shpjegimet e paleve.

Duke u bazuar ne provat e mesiperme, te marra gjate shqyrtimit gjyqesor, gjykata arrin ne perfundimin se pretendimet e kerkuesit jane te bazuara. Qe neni 287 i Kodit Penal te konsiderohet i konsumuar, kerkon pa tjetër ekzistencen e nje vepre penale qe ka si produkt nje pasuri, si dhe veprime, te parashikuara ne kete dispozite, te cilat synojne qe kete pasuri te fituar ne menyre kriminale ta kthejne ne pasuri te paster, pra te ligjshme. Organi i prokurorise nuk ka siguruar te dhena, te cilat te tregojne se origjina e parave te transferuara nga A.L nga Sllovenia ne Shqiperi eshte kriminale. Deklarimet e ketij shtetasi nuk jane verifikuar. Nuk ka te dhena qe tregojne ekzistencen e nje mekanizmi qe ka per synim pastrimin e produktit te ndonje vepre penale, ne shumen 500000 euro. Prokuroria ka vetem dyshime ne lidhje me llogjiken joekonomike dhe kohen e shkurter te kryerjes se transaksioneve, gje e pamjaftueshme per te sekuestruar nje shume prej 427 000 euro. Gjithashtu nuk eshte arsye per sekuestrim fakti se P.G ka qene i hetuar, ndersa A.L ka qene i denoncuar ne disa raste dhe i denuar nje here. Per me teper informacionet jane marre nga autoritetet policore e jo gjyqesore dhe aktualisht asnje nga keta shtetas nuk eshte nen hetim, apo duke u gjykuar. Megjithese ka kaluar nje kohe e gjate nga vendimi i sekuestrimit, me shume se 18 muaj, organi i prokurorise nuk ka siguruar prova per te vertetuar se origjina e parave te sekuestruara eshte kriminale, ka lidhje ndermjet ketyre parave dhe veprave penale per te cilat jane denoncuar personat pjesemarres ne transaksion, ka ndonje mekanizem qe synon nepermjet transaksionit te pastroje produkte te ndonje vepre penale, etj. Ky eshte shkaku qe P.G nuk eshte marre si person nen hetim, apo i pandehur. Ne baze te nenit 210 te KPPenale, sekuestrimi i shumave te depozituara prane bankave behet kryesisht nga gjykata. Ne raste te ngutshme ky vendim mund te merret nga prokurori. Ne rastin konkret prokurori ka vepruar sikur rasti te ishte i ngutshem. Gjykata çmon se nuk jemi perpara ketij rasti. P.G ka dashur ti transferoje parate nga Banka Veneto Shqiperi ne Banken Intesa SanPaolo Shqiperi, pra brenda Republikes se Shqiperise. Prokurori i ka patur te gjitha mundesite t'i drejtohej gjykates, aq me teper qe transaksioni ishte i bllokuar nga banka e DPPPParave. Persa me siper gjykata arrin ne perfundimin se vendimi i sekuestrimit nuk mund te vazhdoje, pasi nuk eshte ne perputhje me nenin 210 te KPPenale. Megjithese ka kaluar nje kohe relativisht e gjate nuk rezzulton se ka arsye te bazuara se shuma e sekuestruar ka lidhje me ndonje veper penale. Per me teper ne nenin 210 cilesohet se shumet mund te sekuestrohen edhe kur nuk i perkasin te pandehurit, ose kur nuk jane ne emer te tij. Ne rastin konkret nuk kemi fare as te pandehur e as person nen hetim.

Pretendimet e paraqitura nga prokurori ne gjykim nuk qendrojne. Vendimi i sekuestrimit edhe kur eshte marre, por me teper tani, pas nje periudhe 18 mujore, nuk eshte

ne perputhje me nenin 210 te KPPenale. Nuk kemi dyshime te bazuara, por vetem supozime. Siç u permend edhe me lart pa te drejte permendet fakti precedente penale, kur P.G rezulton i padenuar, ndersa A.L eshte denuar qe ne vitin 2001. Nuk ka prova qe te lidhin denoncimet, apo hetimet ndaj ketyre dy shtetasve me shumen e sekuestruar. Nuk qendron pretendimi i prokurorit se P.G nuk legjitimohet te kundershtojte vendimin e sekuestrimit ne gjykate, per shkak se nuk eshte as i pandehur dhe as personi i cili ka te drejte per kthimin e sendit te sekuestruar, kur kjo shume eshte transferuar nga shtetasi A.L. Gjykata çmon se P.G legjitimohet pasi shuma e transferuar nga kaluar ne llogarine e shoqerise, perfaqesues ligjor i te ciles ai eshte dhe ky transaksion nuk eshte bllokuar nga banka dhe as nga DPPPParave. Bllokimi e me pas sekuestrimi eshte bere kur ai ka dashur te terheqe parate nga llogaria e shoqerise se tij. Gjithashtu P.G legjitimohet, megjithese nuk eshte i pandehur, pasi ai ka te drejten per kerkimin e sendit te sekuestruar. Ne baze te nenit 212 te KPPenale mund te beje ankim ne gjykate kunder vendimit te sekuestrimit i pandehuri, personi tek i cili jane sekuestruar sendet dhe ai qe ka te drejten e kerkimit te tyre. Parate kane kaluar ne llogarine e shoqerise se P.Gt dhe atje jane sekuestruar, pra P.G ka te drejte te beje ankim ne gjykate, pasi ai eshte personi tek i cili jane sekuestruar sendet, si dhe ai ka te drejten e kerkimit te tyre. Vlen te theksohet edhe fakti se nuk ka patur bllokim e denoncim kur parate kane ardhur nga Sllovenia ne Shqiperi, por kur P.G ka dashur ti transferoje nga njera banke ne nje banke tjeter. Po te kishte qene transaksioni i dyshimte, banka e me pas DPPPParave duhet te kishin vepruar qe kur kishte ardhur shuma nga Sllovenia, pa u kaluar ne llogarine e shoqerise Agar Srl, me perfaqesues shtetasin P.G. Pra rezulton se bllokimi e denoncimi nuk kane patur si arsye dyshimin per vepren penale te parashikuar nga neni 287 i KPenal, pasi veprimet do te ishin kryer qe ne fillim. Nuk qendron edhe pretendimi i prokurorit, i cili i referohet fazes ne te cilen ndodhen hetimet e kesaj çeshtje penale, pasi pasuria e sekuestruar eshte praktikisht dhe objekt i vepres penale te parashikuar nga neni 287 i KPenal. Megjithes veshitresite qe ka hetimi i ketyre veprave penale gjykata, çmon se prokurori ka patur te gjithë kohen e mjaftueshme per te provuar dyshimet e tij, por ne fakt nuk ka siguruar asnje prove per 18 muaj. Ky eshte dhe shkak qe nuk kemi as te pandehur dhe as person nen hetim. Edhe verifikimi i mosperputhjeve ne dokumentacion duhet te ishte bere tashme nga prokuroria, pasi ka patur kohen e mjaftueshme. Gjykata çmon se vetem mbi supozime nuk mund te mbahet e sekuestruar pasuria e individeve apo e shoqerive te ndryshme, per nje kohe teper te gjate dhe per me teper pa patur asnje prove. Dyshimet pa asnje prove nuk konsiderohen nga gjykata te mjaftueshme per te mbajtur ende te sekuestruar shumen prej 427 000 euro. Fakti qe po hiqet sekuestroja nuk tregon se nuk ka veper penale, por aktualisht nuk ka dyshime te bazuara ne prova per ekzistencen e ndonje vepre penale. Persa i perket pretendimit te kerkuesit se Banka Veneto e ka denoncuar kete rast si te dyshuar per shkak se ai do ti terhiqte parate nga kjo banke per ti çuar ne nje banke tjeter, gjykata çmon se ky pretendim mbetet ne bazen e supozimeve e gjate ketij gjykimi nuk provohet.

Ne keto kushte gjykata çmon se kerkesa penale Nr.1114 Akti duhet te pranohet, si e bazuar ne ligj, ne nenin 212 te KPPenale, si dhe ne prova.

PER KETO ARSYE

Gjykata ne baze te nenit 212 te KPPenale:

VENDOSI

- Pranimin e kerkeses.

- Heqjen e sekuestros ndaj llogarise bankare te shoqerise AGAR SRL, me perfaqesues shtetasin P.G, ne shumen prej 427000 euro, prane bankes Veneto, Shqiperi, sekuestruar me vendimin e prokurorit Julian Zonja, dt. 16.04.2010.
- Shpenzimet gjyqesore i ngarkohen kerkuesit.
- Kunder ketij vendimi lejohet ankim ne Gjykatën e Apelit Tirane brenda 10 diteve, duke filluar ky afat nga e nesermja e shpalljes.
- U shpall sot, ne datën 18.10.2011, ne Tirane.

SEKRETARE
Entela SHEHU

GJYQTAR
Petrit ÇOMO